



**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH. A.**



Zyret qendrore
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë
Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, përkatësisht nenin 21, Bordi i Drejtorëve i K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A., Pejë, i emëruar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 10/08, të datës 03.04.2026, në mbledhjen e mbajtur më 02.07.2026, i cili përcakton kompetencat ekskluzive të Bordit të Drejtorëve, me tre (3) vota për, mori këtë:

V E N D I M nr. 14

- I. Emërohet z. Kushtrim Loxha ushtrues detyre i Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF) në KRU "Hidrodrini" Sh.A., Pejë.
- II. I emëruari do ta ushtrojë këtë detyrë me efekt nga data **03.07.2026**, me të gjitha kompetencat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e ndërmarrjes për Zyrtarin Kryesor Financiar, deri në emërimin e Zyrtarit/es Kryesor/e Financiar/e pas përfundimit të procedurave të konkursit publik.

A R S Y E T I M

Pas përfundimit të mandatit të Zyrtarit Kryesor Financiar, Bordi i Drejtorëve, duke u bazuar në kompetencat e tij sipas Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, shqyrtoi nevojën për sigurimin e vazhdimësisë së funksionit të Zyrtarit Kryesor Financiar.

Pas shqyrtimit të kandidatit të propozuar për ushtrues detyre të Zyrtarit Kryesor Financiar në K.R.U. "Hidrodrini" Sh.A., Pejë, Bordi i Drejtorëve, me tre (3) vota për, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesja e Bordit të Drejtoreve



Qendresa Kukaj - Prelvukaj

Vendimi u dërgohet:

- Bordit të drejtorëve;
- NJPMNP – Prishtinë;
- Z. Kushtrim Loxha – UD. ZKF;
- Arkivit të NP-së.